

MOTIVATION OF EMPLOYEES AT THE WORKPLACE

Baki Koleci

University “Hadzi Zeka”, Peja Kosovo baki.koleci@hotmail.com

Abstract: The word motivation comes from Latin from the word “movere” which means “move”. Psychologically, it implies an internal or external stimulus towards action, forces or factors responsible for a certain behavior. Motivation refers to direction, intensity and perseverance in a certain behavior (Geen 1995). Motivation is the desire and the will to do something.

There is a very simple recipe on how to motivate people. The motive depends on the individual, the situation or the people with whom we are working. Motivation theories can only be used as a tool. But managers or executives of the enterprise need to know when and how to use the right tool (theory).

The purpose of drafting this paper is to get acquainted with the aspects and processes of employee motivation, the reasons why they are needed, as well as some of the techniques or forms how it can be forwarded by managers to employees.

We will also try to show the positive consequences it brings to both the psychological and the economic side, as well as to the enterprise itself or the economic organization where it works. In this paper we will try to present as a whole the motivational process that is quite complex and can not be fully understood because in its epicenter are people with their different needs and desires.

Keywords: Motivation, employees, psychology, managers.

MOTIVIMI I PUNONJËSVE NË PUNË

Baki Koleci

Universiteti “Haxhi Zeka” Pejë – Kosovë baki.koleci@hotmail.com

Abstrakt: Fjala motivim vjen nga latinishtja nga fjala “movere” që do të thotë “të lëvizësh”. Nga ana psikologjike, ajo nënkupton një stimul të brendshëm apo të jashtëm drejt veprimit, forcat apo faktorët përgjegjës për një sjellje të caktuar. Motivimi i referohet drejtimit, intesitetit dhe këmbënguljes në një sjellje të caktuar (Geen 1995). Motivimi është dëshira dhe vullneti për të bërë diçka¹⁴⁵.

Ekziston një recetë tepër e thjeshtë mbi mënyrën se si të motivohen njerëzit. Motivi varet nga individ, nga situata ose nga njerëzit me të cilët ne jemi duke punuar. Teoritë e motivimit mund të përdoren vetëm si një mjet. Por menaxherët ose drejtuesit e ndërmarrjes duhet të dinë se kur dhe si të përdorin mjetin e duhur (teorinë).

Qëllimi i hartimit të këtij punimi është që të njihemi më tej me aspektet dhe proceset e motivimit të punonjësve, me arsyet se pse janë të nevojshme ato, si dhe me disa nga teknikat e ose format se si ai mund të përcillet nga ana e menaxherëve për tek punonjësit.

Do të mundohemi që të tregojmë edhe pasojat pozitive që sjell ai si për punonjësin si nga ana psikologjike, por edhe nga ana ekonomike, ashtu edhe për vetë ndërmarrjen apo organizatën ekonomike ku ai punon. Në këtë punim do të mundohemi të prezantojmë si tërësi procesin motivues i cili është mjaft kompleks e nuk mund të kuptohet tërësisht, sepse në epiqendër të tij janë njerëzit me nevojat dhe dëshirat e tyre të ndryshme.

Fjalët Kyçe: Motivimi, punonjësit, psikologjia, menaxherët.

HYRJE

Një përcaktim më i plotë i motivimit vë në dukje 3 aspekte të rëndësishme: Së pari: motivimi përfshin një forcë energjike që i shtyn njerëzit të sillen në një mënyrë të veçantë.

Së dyti: kjo shtytje është e drejtuar diku, pra motivimi është i drejtuar fortë nga qëllimet. Së treti: ideja e motivimit kuptohet më mirë brenda perspektivës së sistemit, që do të thotë se të kuptosh motivimin njerëzor është e rëndësishme të analizosh forcat brenda njeriut dhe ambjentit ku ai jeton dhe ti sigurosh atyre një feedback që përforcon intesitetin dhe drejtimin e tyre.

Motivimi është një term që përdoret për një tërësi elementesh të tillë si dëshirat, nevojat, shtytjet, kërkesat etj. Motivimi ka të bëjë me mënyrën se si shtytjet, aspiratat, nxitjet dhe nevojat e qenieve njerëzore drejtojnë,

¹⁴⁵ <http://www.vitrina.edu.al/wwwweb/index.php?fq=brenda&m=shfaqart&aid=51116>

kontrollojnë apo shpjegojnë sjelljen njerëzore. Një menaxher thuhet se i motivon vartësit e tij atëherë kur ai kryen ato detyra të cilat beson se do të kënaqin nevojat, dëshirat dhe kërkesat e tyre dhe i nxit ata që të veprojnë në një mënyrë të dëshirueshme prej tij. Një njeri në një moment të caktuar kohe mund të ketë motive nga më të ndryshmet, të cilat shpesh mund të jenë dhe në konflikte mes tyre.

Kështu p.sh dikush mund të motivohet nga dëshira për të mira ekonomike si ushqime, veshmbathje, një shtëpi më e mirë, një makinë e re etj. Gjithashtu në të njëjten kohë ai mund të dëshirojë të zërë një pozitë të caktuar në organizatë, të ketë një reputacion të mirë etj, gjëra këto që arrihen duke punuar dhe harxhuar shumë kohë. Nga ana tjetër njeriu mund të ketë sa më tepër kohë në dispozicion për argëtim. Pra në këtë rast ekziston një konflikt motivesh, ky është një tipik i tyre që secili nga ne e ka provuar në jetën e tij jo një herë por dhjetra herë. Ndërmjet motivimit, motivuesëve dhe kënaqësisë ekziston një dallim thelbësor.

Motivuesit janë ato gjëra që nxitin individët për të vepruar në një mënyrë të caktuar. Motivimi pasqyron kërkesat, motivuesit janë shpërblimet apo stimujt konkretë që përdoren për të knaqur këto kërkesa. Ato janë gjithashtu mjetet me anën e të cilave pajtohen nevojat që janë në konflikt ose që duke theksuar një nevojë të caktuar, i japin asaj përparsi kundrejt të tjerëve. Motivuesi është diçka që ndikon ndaj sjelljes së individit, ndërsa motivimi i referohet forcës dhe përpjekjeve për të knaqur një kërkesë apo një synim, kënaqësia i referohet shkallës së knaqësisë së provuar kur kërkesa është përmbushur¹⁴⁶.

MOTIVIMI DHE RËNDËSIA E TIJ

Motivimi është një koncept i dobishëm, pavarësisht prej faktit se ndikimi që ka motivimi, kënaqësia nga puna dhe gjendja morale mbi performancën janë të vështirë për tu matur.

Ndikimi i motivimit dhe kënaqësisë nga puna mbi performancën është shumë i vështirë të matet me saktësi.

a) Motivimi ka të bëjë me përfitimin e niveleve shtesë të angazhimit dhe performancës nga punonjësit, është diçka të vepruarit ë thjeshtë në përputhje me rregullat dhe procedurat.

b) Fakti se kënaqësia nga puna është një faktor në përmirësimin e performancës nuk është provuar.

c) Çelësi është të punohet “me mençuri” – jo domosdosmërisht “më shumë”.

Gjendja morale është një term që përdoret kryesisht në një kontekst ushtarak, për të treguar gjendjen mendore e shpirtërore të një grupi, sidomos aspektin që ka të bëjë me disiplinën dhe besimin. Ajo mund të ketë të bëjë me kënaqësinë, meqenëse gjendja e ulët morale nënkupton mungesën e kënaqësisë.

Ka disa evidenca që kënaqësia është në përpjestim të drejtë me shëndetin mendor, në këtë mënyrë simptomat e **stresit** ose problemeve psikologjike mund të jenë një sinjal që diçka nuk është mirë.

ASPEKTET E MOTIVIMIT

Motivimi është njëra prej çështjeve të përhershme; për udhëheqës dhe punëtorë për shkencëtar sikur që janë psikologët, sociologët. Çështja themelore është se si krijohet një qëndrim dhe stil i menaxhmentit i cili do të sjellë deri te rezultatet e duhura, përkatësisht sjelljet deri te motivimi i punëtorëve për realizimin e rezultateve të cilat priten. Çështja e motivimit është e lidhur me problematikën e sjelljes së punëtorëve dhe çështjes praktike rreth marrjes së vendimeve të cilat në jetën e përditshme i marrin menaxherët. Nuk duhet harruar se në mes të ndërmarrjes dhe individit ekziston një fshehtësi e cila i ngjet situatës së tendosur:

- Individit e synon autonominë, zgjerimin e detyrave të punës duke zbatuar idetë e veta.

- Ndërmarrja synon që individit ti nënshtrohet dhe ti përshtatet instrumentalizimit.

Tendosja në mes të individit dhe ndërmarrjes në afarizmin e sotëm gjithnjë e më shumë është duke u rritur për shkakë të shtimit të nderlikushëmëris së detyrave të punës.¹⁴⁷

Ndërmarrëjet moderne duhet ti vënë në baraspeshë detyrat e punës dhe variablat;

- Kënaqësia e konsumatorëve

- Profitabilitetin e synuar dhe

- Kënaqësin e punëtorëve

Në bazë të kësaj motivimi më së thjeshti mund të definohet si gadishëmei që të bëhet plotësimi i nevojave të individit [fiziologjike, psikologjike] në mënyrë të paramenduar. Në të vërtet me këtë vijmë dei te termi motiv, përkatësisht nevoja për definimin e motivit. Motiv është krejt ajo çka i vën në levizje, që nxitë njerzit të sillen në mënyrë të caktuar, nëse mbështetmi në këtë motivet mund ti ndajmë në;

- Pozitive dhe

¹⁴⁶ Ekonomia e përgjithshme 2

¹⁴⁷ Menaxhment Prof.dr. Robert Dimitrovski Shkup 2010

- Negative

Motivet pozitive mbështeten në angazhimin vullnetar të të punsuarëve për realizimin e qëllimeve të parashtruar nga ndermarrëja, sepse motivi i tyre përafërsisht përmbushet duke u përmbushur motivi i ndermarrjes. Ndërsa motivi negativ mbështetet në kërcnime, friksime, dënime etj, pra motivi është një gjendëje e pabaraspeshës në të cilën individi nga një ndijenje e brendëshme përkatësisht nga ndonjë motiv është nxitur që ta realizoj qëllimin.

KONKLUZIONE

Si tërësi procesi motivues është mjaft kompleks e nuk mund të kuptohet tërësisht, sepse në epiqendër të tij janë njerëzit me nevojat dhe dëshirat e tyre, megjithë atë një kuadër i përgjithshëm dhe i thjeshtëzuar i tij.

Ky proces ciklik si moment fillestar ka nevojat e pa plotësuara. Një nevojë e pakënaqur është pika e parë që shërben si shtytje për të shkaktuar një tension fizik apo psikologjik brenda njeriut., pas të cilit vijnë një sërë veprimesh një sjellje e caktuar e tij për të arritur kënaqjen e nevojës. Me arritjen e kënaqësisë mbyllet edhe cikli motivues për të vazhduar përsëri këtë rrugë për kënaqjen e një nevojë tjetër. Në jetën e përditëshme njerëzit kanë nevojat nga më të ndryshmet, si nevojat për ushqim, për strehim, për zhvillimin e vazhdueshëm të potencialit të tyre intelektual, për dashuri etj. Si rezultat i përpjekjeve të tyre njerëzit provojnë nivele të ndryshme të kënaqjes së nevojave. Masa me të cilën njerëzit i konsiderojnë të kënaqura nevojat e tyre do të ndikojë në përpjekjet e ardhëshme të tyre për të plotësuar të njëjtat nevojat.¹⁴⁸

Kështu për shembull në qoftëse të ka marrur uria do të kërkojë një restorant për të kënaqur nevojën e urisë, por në qoftë se ushqimi ishte i bollshëm por jo i shijshëm, ka shumë të ngjarë që herën tjetër të kërkojë një vend tjetër për të ngrënë. Duke pasur parasysh nivelin e provuar të kënaqësisë i cili përcakton edhe veprimet apo përpjekjet për plotësimin e ardhëshëm të nevojave procesi motivues

LITERATURA

- [1] <http://www.vitrina.edu.al/wwwweb/index.php?fq=brenda&m=shfaqart&aid=51116>
- [2] Ekonomia e përgjithshme 2
- [3] Menaxhment Prof.dr. Robert Dimitrovski Shkup 2010
- [4] Bazat e Menaxhimit Robins 2011

¹⁴⁸ Bazat e Menaxhimit Robins 2011